



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:053431
Datë: 19.03.2025
Numri i dokumentit: 07011100

Ep.nr.16/2025

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Drilon Hoxha në çështjen juridike përmbaremore të kreditorit: Banka L Sh.A, me seli në Prishtinë, rruga “R. L.” nr....., ndaj debitorit: O. K., me adresë në Fsh. V., Komuna Pejë, me bazë juridike: zbraze dhe dorëzim i paluajtshmërisë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbareuesit Privat F Sh., P.nr.600/19, i datës 23.12.2019, jashtë seancës gjyqësore, me datë 19.03.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET si i themeltë prapësimi i debitorit ashtu që SHFUQIZOHET Urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr.600/19, i datës 23.12.2019, i përmbareuesit privat F Sh., përmbareues për territorin e Gjykatës Themelore në Pejë- dega në Istog.

II.Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Kreditori L Sh.a me seli në Prishtinë, me datë 23.12.2019 ka parashtruar propozim për lejimin e përmbaremit ndaj debitorit O. K., në bazë të titulli ekzekutiv Urdhërit Përmbareimor P.nr.681/14 të datës 21.12.2017, me kërkesë që t’ia dorëzoj në posedim paluajtshmërinë-parcelën kadastrale nr.P-..... V., Zona Kadastrale Pejë, në sipërfaqe prej 768 m2 dukë kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Përmbareuesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhër nën shenjën P.nr.600/2019 të datës 23.12.2019 duke lejuar përmbareimin e propozuar.

Kundër këtij urdhëri mbi lejimin e përmbareimit prapësim ka parashtruar M. K., përmes të autorizuarit të saj M.t K., duke theksuar se e kundërshtoj propozimin për përmbareim për shkak se i njëjti është i njëanshem, duke i propozuar gjykatës që ta hudhë poshtë urdhërin përmbareimorë, pasi që ende nuk ka përfunduar procedura kontestimore.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, duke i propozuar gjykatës që t'a refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të vazhdohet me procedurën përbarimore sipas propozimit për përbarim.

Gjykata duke vendosur sipas prapësimin, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjegjes në prapësim, me aktvendimin Ep.nr.198/2020 të datës 20.03.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e parashtruar nga M. K.

Gjykata e Apelit duke vendosur sipas ankesës së debitorit me aktvendimin CAP.nr.532/2023 të datës 06.02.2025, e ka prishur aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Ep.nr.198/2020 të datës 20.03.2023 dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, erdhi në përfundim se prapësimi është i bazuar.

Në rastin konkret ne bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës del së propozimin për përbarim e ka paraqitur kreditori: L Sh.a me seli në Prishtinë, kundër debitorit: O. K., në bazë të titullit ekzekutiv Urdhërit përbarimor P.nr.681/14 të datës 21.12.2017, i cili titull siq del të jetë në shkresat e lëndës nuk e përmban klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmeri ashtu siq parashihet me nenin 36 par.1 dhe 2 të LPP-së: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmeri”*. Vërtetimin për përbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë.

Në këtë rast kreditori ka ushtruar propozim për përbarim në bazë të dokumentit përbarimor Urdhërit të lartcekur. Në një situatë të tillë përbaruesi privat si organ përbarues është i obliguar që të vlerësojë nëse janë përmbushur prezumimet lidhur me përmbajtjen dhe dhënat tjera që duhet ti bashkëngjiten propozimit për përbarim, pasi që sipas nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së, përcaktohet se: *“ Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitorit, adresa e vendbanimit - vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe debitorit, kredia që kërkohet të realizohet si dhe mjete nëpërmjet të cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po që së është i njohur, si dhe të dhënat e tjera të nevojshme që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit ”*. Ndërsa me paragrafin 2 të nenit 38, të këtij ligji, përcaktohet se: *“ Në rast se propozimi për përbarim nga paragrafi 1, i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102, të Ligjit të Procedurës Kontestimore ”*.

Në këtë rast organi përbarues - përbaruesi privat, para se të nxjerr urdhrin mbi lejimin e përbarimit, ka pasur për detyrim ligjor që të vlerësojë se propozimi për përbarim i paraqitur nga kreditori a përmban të dhënat e mjaftueshme, të cilat kërkohen me nenin 36 par 1 dhe 2 dhe

38 paragrafi 1 të LPP-së, dhe në rast se propozimi për përmbarrim nuk ka përmbajtur të gjitha të dhënat e nevojshme, atëherë nuk ka pasur pengesa ligjore që konform nenit 17 dhe 38 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, e lidhur me nenin 102 të LPK-së, të ftoj kreditorin që brenda afatit kohor ligjor të bëjnë plotësimin, rregullimin dhe precizimin e propozimit për përmbarrim, duke e njoftuar qartë kreditorin edhe për lëshimet procedurale në rast mosveprimi sipas urdhrin të organit përmbarrues, brenda afatit kohor ligjor të dhënë, që pastaj varësisht prej veprimit apo mosveprimit nga ana e kreditorit, organi përmbarrues-përmbarruesi privat të kishte mundësi që të ndërmerre hapat tjerë procedural të paraparë me ligj.

Gjykata me rastin e vlerësimit të prapësimit dhe përgjegjës në prapësim, ka pas parasysh edhe pretendimet tjera të kreditorit dhe debitorit për të cilat ka gjetur se janë pa ndikim për një vendosje ndryshe të kësaj çështje.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përrjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.*

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 të LPP-së.

Andaj nga të lartëcekurat e duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 36, 38, 43 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
Ep.nr.16/25, me datë 19.03.2025

Gj y q t a r i
Drilon Hoxha

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.